



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 14, paragrafi 2, dhe Dispozitat e Nenit 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr.03/L-185):
- Dispozitat e Nenit 12, paragrafi 1.18 të Ligjit për Energjinë elektrike (Ligji Nr. 03/L-201);
- Kërkesën e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT Sh.A) të datës 16.10.2013 për shqyrtim dhe aprovim të dokumentit “Metodologjia e taksave të kyçjes në rrjetin e transmisionit”,

në seancën e mbajtur me datë 24 tetor 2013, nxori këtë:

VENDIM

I. APROVOHET amandamenti i dokumentit “Metodologjia e taksave të kyçjes në rrjetin e transmisionit” të KOSTT Sh.a.

Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 16.10.2013 ka pranuar kërkesën KOSTT Sh.a. për shqyrtim dhe aprovim të dokumentit “Metodologjia e taksave të kyçjes në rrjetin e transmisionit”.
- Dokumenti ka kaluar në disa faza të komentimit për një kohë të gjatë që nga data 13 mars 2013 kur është dërguar për herë të parë për amendamentim. ZRRE ka dhënë komentet e veta si drejtpërdrejt përmes takimeve, dhe në formë të shkruar.
- Pas dorëzimit nga KOSTT të versionit final me datë 16.10.2013, ZRRE ka vlerësuar se dokumenti i dërguar “Metodologjia e taksave të kyçjes në rrjetin e transmisionit”, i përmbush kriteret për aprovim, dhe duke marrë parasysh dispozitat ligjore të cekura në hyrje, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- Ky vendim anulon versionin e dokumentit paraprak “Metodologjia e taksave të kyçjes në rrjetin e transmisionit” të datës 21 korrik 2010.

II. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.



III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, ku do të publikohet edhe dokumenti. Dokumenti do të publikohet edhe në faqen elektronike zyrtare të KOSTT-it

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Vendimit i bashkëngjitet dokumenti “Metodologjia e taksave të kyçjes në rrjetin e transmisionit”

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar